




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH.nr. 342/19**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi– Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Eor Group” shpk–Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Furnizim me telefona mobil për nevojat e AKK-së” me nr. i prokurimit 623-19-3414-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Agjencia Qendrore e Prokurimit /AQP/, më datë: 26.07.2019, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Furnizim me telefona mobil për nevojat e AKK-së” me nr. i prokurimit 623-19-3414-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Agjencia Qendrore e Prokurimit /AQP/.

**II. ANULOHET**, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Furnizim me telefona mobil për nevojat e AKK-së” me nr. i prokurimit 623-19-3414-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Agjencia Qendrore e Prokurimit /AQP/, dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim**.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: "Eor Group" shpk--Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Data e njoftimi për kontratë është bërë me dt: 21.05.2019.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt: 29.05.2019.

Operatori ekonomik ankues: "Eor Group" shpk--Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 03.06.2019, me nr.342/19, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me telefona mobil për nevojat e AKK-së" me nr. i prokurimit 623-19-3414-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Agjencia Qendrore e Prokurimit /AQP/, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, dhe 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 17.06.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues dhe ekspertin te jashtëm teknik, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues dhe eksperti i jashtëm teknik, në raportin e dt: 04.07.2019, sqaron se arsyeja e eliminimit të OE qëndron në faktin se i njëjti në ofertën e tij nuk ka paraqitur "Katalog ose fotografi me ngjyra se bashku me përshkrimin teknik për artikullin që ofertoni." Sipas Përgjigje në Pretendimin Ankimor.

Bazuar në dosjen e Tenderit përkatësisht Specifikimi teknik si dhe Ofertës së OE Ankuese rezulton se i njëjti në dosjen e tij, ka të bashkangjitur Broshurën për Pajisjet e kërkuara dhe të njëjtat plotësojnë specifikimin teknik sipas kërkesës.

Modeli 1 = Oferta e OE është IPHONE 7 Plus 32GB gjë që plotëson të gjitha specifikat sipas kërkesës.



Modeli 2 = Oferta e OE është IPHONE X 64GB gjë që plotëson të gjitha specifikat sipas kërkesës.

Andaj në bazë të gjitha shkresave për këtë lëndë konsideroj se Ankesa është e Bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik, i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në Rivlerësim.

Operatori ekonomik "Eor Group" shpk-Prishtinë, përmes parashtresës me shkrim të datës: 07.07.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 26.07.2019, ku kanë qenë prezent kryetari i paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i AK-së, eksperti teknik, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për anulim, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së, z. Velu deklaroj: Jemi pajtuar me ekspertizën, për OE "Eor grup" mbetet pran pretendimeve ankimore të dorëzuara me ankese dhe njëheritë pajtohem plotësisht me konstatimet e ekspertit shqyrtues duke e konsideruar raportin e ekspertizës objektiv profesional dhe ligjor. Lidhur me lenden 342/19, që lënda të kthehet në rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së, znj. Tolaj deklaroj: OE ankues pasi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku ka potencuar nënën e shkelura nuk qëndron asnjëri nga këto pretendime sepse nësi komision vlerësues kemi konstatuar asnjë nga OE ofertues nuk i kanë plotësuar kërkesat sipas përshkrimit të specifikimit teknik.

Sa i përket raportit të ekspertit shqyrtues nuk është thelluar në arsyen e eliminimit të OE dhe nuk ka bërë një krahasim në mes të spec.teknik që ka qenë kërkesë dhe katalogut të ofruar nga ana e OE sepse nëse i bëjmë një analizë të shkurtër në mes të spec.tekn katalogut të ofruar të OE ankues dhe njoftimit mbi vendimin e Autoriteti Kontraktues gjegjësisht letrës standarde për eliminim unë besoj që nuk do të vim në rezultatin e dhënë nga ekspertiza. Katalogu i ofruar nuk përshkon me kërkesat e Autoriteti Kontraktues.

Gjatë prezantimit në seancë ekspert i jashtëm teknik z. Hisenaj deklaroj: Qëndroj prapa raportit të ekspertizës edhe deklarimeve këtu në seancë me çka oferta teknike është në përputhje të plote me kërkesën e Autoriteti Kontraktues sipas kërkesës në DT këtë e mbështes në faktin se kam analizuar të gjithë DT dhe ofertën e OE në fjalë dhe të gjitha përputhën një me një, andaj edhe kërkesa për këtë produkt nga vet Autoriteti Kontraktues të shpie në vetëm në dy (2), modele të caktuara dhe si të tilla për vetëm këto dy (2) modele që ka ofruar OE ankues asnjë tjetër nuk mund të plotësojë andaj konsideroj se Oferta përputhet me kërkesën e Autoriteti Kontraktues, për çka mund të marrim të analizojmë edhe pike për pikë.

Edhe pas deklarimit të përfaqësuesit të Autoriteti Kontraktues qëndroj prapë raportit nëse marrim spec.teknik dhe shohim ofertën e OE, Oferta është në përputhje me kërkesën. Kjo kërkesë që e ka paraparë Autoriteti Kontraktues kjo ka do që të shikohet vetëm tek këta dy telefona i plotësojnë kërkesën.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së, z.Veliu deklaroj: Kërkojmë që ankesa jone të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së, znj Tolaj deklaroj: Kërkojë që të refuzohet ankesa e OE ankues dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoriteti Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjeve të provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se OE ankues "Eor Group" shpk-Prishtinë, pretendon se është eliminuar pa të drejtë nga ana e autoritetit kontraktues AQP, me arsyetimin si në vijim: OE "Eor Group" shpk-Prishtinë, në ofertën e tij nuk ka paraqitur "Katalog ose fotografi me ngjyra se bashku me përshkrimin teknik për artikullin që ofertoni."

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik konstaton se bazuar në dosjen e Tenderit përkatësisht Specifikimi teknik si dhe Ofertës së OE ankuese OE "Eor Group" shpk-Prishtinë, rezulton se i njëjti në dosjen e tij, ka të bashkangjitur Broshurën për Pajisjet e kërkuara dhe të njëjtat plotësojnë specifikimin teknik sipas kërkesës së autoritetit kontraktues AQP.

Modeli 1 = Oferta e OE është IPHONE 7 Plus 32GB gjë që plotëson të gjitha specifikat sipas kërkesës së AK-së.

Modeli 2 = Oferta e OE është IPHONE X 64GB gjë që plotëson të gjitha specifikat sipas kërkesës së AK-së.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në të gjitha shkresat e lëndës si dhe në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit vjen në përfundim se anulimi i aktivitetit të prokurimit në fjalë është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, dhe nenit 44.7 të RrUPP, gjithashtu autoritetit kontraktues AQP, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi e ofertave nuk e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së. Prandaj, obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave ligjore të zbatueshme për këtë aktivitetet të prokurimit dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK - Agjencia Qendrore e Prokurimit /AQP/

1x1 OE -"Eor Group"-shpk-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.